



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 20.4.2023

Nr: 392

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**EMËRIM ANËTARI TË KZAZ NR. 75, BASHKIA KOLONJË, TË PROPOZUAR NGA PARTIA  
DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË  
DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 7, të Vendimit nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V Ë R E N

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor, Partia Demokratike e Shqipërisë, me shkresën nr. 3883 prot., datë 17.4.2023, ka kërkuar emërimin e anëtarit në KZAZ nr. 75, Bashkia Kolonjë.

Pas kryerjes së verifikimit të dokumentacionit, me plotësim të tij nga Partia Demokratike e Shqipërisë, dhe verifikimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezultojnë që propozimet dhe kandidaturat e paraqitura, plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, paragrafi 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

Data: 20.4.2023 Nr: 392  
Ora:11:00



“Për emërim anëtarit të KZAZ nr. 75, bashkia Kolonjë, të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

## **V E N D O S:**

1. Emërimin e anëtarit të KZAZ-së nr. 75, z. Bilbil Seit Jaçe, Bashkia Kolonjë, të propozuar nga Partia Demokratike e Shqipërisë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**